



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.21

Prishtinë, më 22.07.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N -302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Srdjan Popović dhe Mufera Sinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Ukë Gashi-ZPRK, Tringa Bytyqi-GLPS, Bekim Kodraliu-OSBE, Petrit Hysaj-OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 14. dhe 15.07.2015.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni miratoi rendin e ditës me ndryshimin e propozuar nga anëtarët e Komisionit për heqjen e pikës 3 të rendit të ditës për shqyrtimin e Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14. dhe 15.07.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 14 dhe 15.07.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor

Nait Hasani, tha se në fushë veprimin e Komisionit përfshihet edhe shqyrtimi i raportit të Këshillit për Trashëgimi Kulturor. Ai theksoi se nga administrata e Kuvendit ka dal një vendim sipas të cilit raportet e Këshillave që nuk kanë bord të mos shqyrtohen, megjithatë Komisioni ka marr vendim që ta shqyrtoj këtë raport për shkak të buxhetit të madh që ndahet për këtë Këshill dhe ne duhet të dimë se si është shpenzuar ai buxhet. Ai tha se Komisioni i ka propozuar anëtarët e bordit të Këshillit për Trashëgimi dhe kemi bërë kërkesë drejtuar kryesisë për riprocedimin e kësaj liste apo të rishpallet konkursi.

Teuta Haxhiu, tha se un nuk e miratoj këtë raport dhe jam që të diskutohet në Kuvend sepse përderisa ky Këshill financohet nga Kuvendi atëherë ne duhet ta dimë se si janë shpenzuar mjetet. Në vazhdim tha se personalisht kam pas shumë kërkesa për mbrojtjen e disa objekteve të vjetra dhe asgjë nuk është bërë në këtë drejtim nga ky Këshill. Ajo theksoi se është shumë shqetësuese se si kryesia e Kuvendit nuk ka marr asnjë hap për riprocedimin e listës me anëtarët e bordit, duke e ditur se ne çfarë gjendjen është Këshilli për Trashëgimi Kulturor.

Ismajl Kurteshi, tha se në raport mungojnë shumë fakte dhe dokumente, është folur për aktivitete pa u dëshmuar me asnjë lloj dokumenti, analizat nuk i janë bashkangjitur raportit, bëhet fjalë për aktivitete që kanë ndodhur në vitin 2012 dhe 2013, masat financiare i kanë numëruar si aktivitete dhe në këtë raport është përfshirë vlerësimi i projekteve që nuk është detyrë e Këshillit por e Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, nuk gjendet asnjë dokument se çfarë konsolidimi i trashëgimisë të rrezikuar ka ndodhur gjatë këtyre viteve, rreth 30 aktivitete janë përsëritur nga vitet e mëparshme dhe është folur për rezultate të punës por nuk ka rezultate bindëse dhe më tepër kanë ndodhur udhëtime zyrtare të cilat kanë shkaktuar shpenzime të shumta. Ai theksoi se duhet të shihet se cila është baza ligjore që ky Këshill funksionon pa bord dhe vet ekzekutivi merr vendime për shpenzimet marramendëse pa vendime politike prandaj kërkoj që ky raport të shkoj për debat në Kuvendin e Kosovës dhe si anëtarë i Komisioni nuk e aprovoj këtë raport.

Shpejtim Bulliqi, tha se ky raport nuk i ngjanë fare një raporti të punës prandaj mendoj që për të gjitha këto duhet të iniciohet një procedurë dhe të shohim se kush është përgjegjës për këto ndryshime që janë bërë gjatë gjithë kësaj periudhe për arsye se buxheti i Kosovës është shpenzuar dhe nuk kemi asnjë rezultat të argumentuar.

Shukrije Bytyqi, tha se përderisa Kuvendi është themelues i Këshillit duhet të vazhdoj procedura e mbikëqyrjes së tij sepse ky Këshill merr një shumë të madhe të mjeteve dhe në raport janë shkruar disa tabela për shpenzime por nuk janë argumentuar, prandaj duhet të përcjellët për seancë ky raport pa miratimin tonë dhe Kuvendi të merr hap për themelimin e bordit të këtij Këshilli sepse ne kemi bërë përzgjedhjen e anëtarëve në mënyrën shumë transparente. Në vazhdim theksoi se Këshilli nuk ka ndërmarr asnjë hap për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe për promovimin e kulturës sonë në rajon.

Nait Hasani, tha se duhet të kërkojmë që ky raport të hy në seance si pikë e rendit të ditës dhe të theksohet se Komisioni nuk e miraton raportin e këtij Këshilli për shkak të mos themelimit të bordit sepse është bordi ai që i përcakton politikat brenda Këshillit dhe po të kishte bord do të kishim një pasqyrë më të plotë të të gjitha aktiviteteve dhe shpenzimeve.

4. Të ndryshme

Nait Hasani, propozoi që në seancën e radhës në Kuvend të hy si pikë e rendit të ditës propozimi i Komisionit, për krijimin e Komisionit hetimor për vlerësimin e ndërtimit të shkollave sepse kemi kërkuar buxhet shtesë për ndërtimin e shkollave, buxheti është shpenzuar ndërsa shkollat ende nuk janë përfunduar.

Shpejtim Bulliqi, tha se kam lexuar përmes mjeteve të informimit rreth një udhëzimi administrativ që e ka nxjerr Ministria e Arsimit për Fakultete, sipas të cilit mbivlerësohet Fakulteti i Edukimit duke i lënë anash fakultetet bazike. Ai tha se duhet ta ngrisim këtë problem sepse nuk guxojmë Fakultetet bazike, që janë bërthama e shkencës të lihen anash duke i dhënë përparësi Fakultetit të Edukimit.

Nait Hasani, tha se për çështjen e këtij udhëzimi administrativ duhet të ftohet ministri i arsimit në mbledhjen e ardhshme dhe të diskutojmë për të.

Teuta Haxhiu, tha se në një vizitë në komunën e Dragashit, 200 nxënës shqiptar të shkollës së mesme ishin të detyruar të udhëtojnë në Prizren. Ajo theksoi se është mirë që ne ti ftojmë mësimdhënësit nga komuna e Dragashit dhe të diskutojmë për arsyen e largimit të nxënësve në shkollat në Prizrenit dhe për rënien e numrit të nxënësve.

Ismajl Kurteshi, tha se përgjigjet nga Ministria e Arsimit, për pyetjet për monitorim të Ligjit për Arsimin Parauniversitar kanë ardhur. Ai pyeti se a mendoi që pas shqyrtimit të atyre pyetjeve të organizohet një takim me kabinetin e Ministrisë apo te punojmë në bazë të atyre përgjigjeve.

Nait Hasani, tha se do të ishte më mirë sikur të punojmë në bazë të atyre përgjigjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani